




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	2-0/DPK
Nr. i tag	
Broj - stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	01-2986/15
Br. Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	30-09-2015
Date	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupcionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupcionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupcionit me datë 30.09.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-02-2512-15 për z.Jeton Vorfi – Këshilltar komunal në Komunën e Gjakovës, për shkak se ështëshmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z.Vorfi ka dhënë dorëheqje nga pozita e personit të autorizuar në biznesin privat.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2512-15, për Zyrtarin e lartë, z.Jeton Vorfi–Këshilltar komunal në komunën e Gjakovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Vorfi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupcionit, pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupcionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Vorfi, është deklaruar se do t'i bëjë ndryshimet e kërkua nga Agjensioni për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupcionit, ka sjell shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK/DPKI-03-02-2952/15) në të cilën shihet se z.Vorfi tashmë ka emëruar një person të besuar në biznesin "N.Sh."Valeri", duke shmangur kështu konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

/ Hasan Preteni /

